

## **Shkodran IMERAJ**

# **SHPALLJA E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MË 17 SHKURT 2008**

### **Hyrje**

Pas luftës së viteve 1998-1999, Kosova u vendos nën administrimin ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara nën misionin UNMIK (Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara), i cili kishte për detyrë të krijonte kushtet për stabilitet dhe zhvillim demokratik. Në këtë periudhë, KFOR-i (Forca paqeruajtëse e NATO-s) siguroi paqen dhe sigurinë në gjithë territorin e Kosovës. Një rol të rëndësishëm luajti edhe Këshilli Tranzitor i Kosovës, si organ përfaqësues i partive politike dhe komuniteteve, që parapriu formimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ). Pas vdekjes së presidentit Ibrahim Rugova në vitin 2006, Kosova kaloi në një periudhë të ndërlikuar politike, me ndryshime të theksuara në udhëheqje dhe në balancën mes partive kryesore politike, duke sjellë sfida të mëdha për stabilitetin dhe për procesin e negociimit të statusit përfundimtar të Kosovës. Kjo periudhë kulmoi me zgjedhjet e vitit 2007, që përgatitën terrenin për shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.

### **Konsolidimi i Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë gjatë administrimit të UNMIK-ut (1999-2008)**

Me nënshkrimin e Marrëveshjes tekniko-ushtarake në Kumanovë të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, më 9 qershor 1999, ndërmjet gjeneralit britanik Michael Jackson, në emër të forcave aleate të NATO-s, dhe gjeneralit serb Nebojsa Pavković, shef i Shtabit të Ushtrisë Jugosllave, u hap rruga për ndaljen e bombardimeve të NATO-s mbi objektivat e Jugosllavisë. Kjo mundësoi hyrjen e trupave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë dhe vendosjen e administratës civile të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), të njohur si UNMIK.

Marrëveshja tekniko-ushtarake e nënshkruar mes NATO-s dhe Serbisë, e njohur edhe si Marrëveshja e Kumanovës, hyri në fuqi më 11 qershor 1999,

pra dy ditë pas nënshkrimit të saj. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në mbledhjen e tij të 4011-të më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244, me të cilën e vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara përmes misionit UNMIK.<sup>1</sup>

Në bazë të nenit 6 të Rezolutës 1244, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, në bashkëpunim me Këshillin e Sigurimit, kishte të drejtën për të emëruar përfaqësuesin special,<sup>2</sup> pra kryeadministratorin e Kosovës, i cili do të udhëhiqte misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të njohur ndryshe si UNMIK. Në këtë funksion, Kofi Annan emëroi diplomatën nga Brazili, Sérgio Vieira de Mello, si kryeadministrator të parë të Kosovës.

Vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, sipas Rezolutës 1244 të 10 qershorit 1999, ishte një mision me detyrë të administrimit të territorit brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974. Në bazë të kësaj rezolute të Këshillit të Sigurimit, në Kosovë u dislokua edhe forca paqeruajtëse e NATO-s, me emrin KFOR (Kosova Force), e cila operonte në gjithë territorin e saj. Nga aleanca e NATO-s u emërua gjenerali britanik Sir Michael David Jackson, një gjeneral i ushtrisë britanike, për të shërbyer si komandant i parë i trupave paqeruajtëse të misionit KFOR në Kosovë.

Administrimi ndërkombëtar i Kosovës nga administrata e UNMIK-ut ndahet në tri faza:

- Faza e parë nis me vendosjen e misionit në Kosovë dhe zgjat deri në tetor të vitit 2001, kur u mbajtën zgjedhjet e para shumëpartiake.
- Faza e dytë fillon me themelimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës dhe përfundon më 17 shkurt 2008, kur Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë.
- Faza e tretë fillon pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku misioni nuk ka më kompetenca ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës filloi faza e mbikëqyrjes ndërkombëtare të funksionimit të organeve shtetërore të Republikës së Kosovës, e cila zgjati deri në shtator të vitit 2012.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> United Nations, S/RES/1244 (1999) 10 June 1999, Resolution 1244 (1999), f. 1-8.

<sup>2</sup> Po aty, f. 2.

<sup>3</sup> Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, gjatë fazës së mbikëqyrjes ndërkombëtare të funksionimit të organeve shtetërore të Kosovës (2008-2012), ishte Pieter Feith.

## **Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative dhe Këshilli Tranzitor i Kosovës**

Në janar të vitit 1999, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara vuri bazat e institucioneve të Kosovës. Kështu, më 14 janar 2000, ai shpalli të miratuar Rregulloren nr. 2000/1, mbi strukturën e përbashkët të përkohshme administrative në Kosovë. Sipas nenit 1, pika c, Struktura e Përbashkët Administrative e Kosovës do të fillojë funksionimin më 31 janar 2000. Në kuadër të saj do të përfshihen të gjitha strukturat ekzistuese të Kosovës, përfshirë organet ekzekutive, ligjvënëse dhe gjyqësore, si dhe Qeverinë e Përkohshme të Kosovës dhe Presidencën e Republikës së Kosovës. Pas kësaj date, të gjitha funksionet e mëparshme të këtyre strukturave do të ndërpriten.<sup>4</sup>

Ajo që bie në sy në këtë nen është se edhe të gjitha komunitetet në Kosovë do të përfshiheshin në strukturën e përkohshme administrative. Përfshirja e tyre në këtë organ administrativ do të bëhej në bazë të procedurave që kishte rregulluar kjo rregullore. Këshilli Tranzitor i Kosovës ishte një strukturë e rëndësishme dhe pararendëse e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Ai shërbeu si një urë lidhëse ndërmjet administratës ndërkombëtare dhe komuniteteve lokale, duke luajtur rol kyç në themelimin dhe funksionimin e Institucioneve të para Vetëqeverisëse pas periudhës së pasluftës në Kosovë.

Përbërja e Këshillit përfshinte përfaqësues nga administrata ndërkombëtare, përfaqësuesit politikë lokalë, si dhe përfaqësuesit fetarë dhe komunitete të ndryshme etnike, për të garantuar një përfaqësim të drejtë dhe për të promovuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve. Në këtë mënyrë, Këshilli Tranzitor hapi rrugën për krijimin e institucioneve më të avancuara dhe demokratike që do të zhvilloheshin më vonë, duke kontribuar në stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës.

## **Korniza Kushtetuese e Kosovës**

Për të mbështetur organizimin dhe për të siguruar mbështetje ligjore, përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë nisën hartimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë. Korniza Kushtetuese për

<sup>4</sup> Shih me detaje: United Nations, United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, Rregullore, Rregullore Nr. 2000/1.

Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë ishte një akt ligjor themelor i miratuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), më 15 maj 2001. Ky dokument me rëndësi jetike në funksionimin e Kosovës u miratua nga Hans Haekkerup, kryeadministrator i Kosovës.<sup>5</sup>

Korniza Kushtetuese e Kosovës ishte dokument i cili shënoi një hap të rëndësishëm në zhvillimin e Institucioneve Vetëqeverisëse dhe administratës demokratike në Kosovën e pasluftës.

Korniza Kushtetuese e Kosovës përcaktoi bazat e ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, e cila ishte e ndërtuar në 14 krerë, të cilëve u paraprinte preambula.

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë legjislativ, i dalë nga zgjedhjet e lira, kishte përgjegjësinë të nxjerrë ligje, të zgjedhë Presidentin e Kosovës dhe të votojë qeverinë.

Presidenti përfaqësonte unitetin e popullit dhe garantonte funksionimin e institucioneve demokratike. Ndërsa, qeveria ishte përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe zhvillimin e politikave publike.

Korniza Kushtetuese e Kosovës përcaktoi edhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejtave të komuniteteve dhe të minoriteteve, si dhe parimet e një ekonomie të tregut dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Një element tjetër i rëndësishëm ishte parashikimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës me përfaqësuesit ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Kjo Kornizë ishte e përkohshme, deri në përcaktimin përfundimtar të statusit të Kosovës, dhe shërbeu si bazë për ndërtimin e një sistemi demokratik në gjithë territorin e Kosovës.

## **Zgjedhjet komunale dhe konsolidimi i institucioneve qendrore të Kosovës**

Zgjedhjet për Kuvendet Komunale, të mbajtura më 28 tetor 2000, nga të cilat u zgjodhën edhe kryetarët e komunave në gjithë Kosovën, ishin me rëndësi të veçantë për vendin. Në gjithë territorin e Kosovës u organizuan zgjedhjet e para të lira dhe demokratike, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës, me mbështetjen e misionit të UNMIK-ut dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE). Këto zgjedhje u fituan

---

<sup>5</sup> United Nations, United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, f. 1-29.

fuqishëm nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova.<sup>6</sup>

Pas zgjedhjeve komunale, më 21 tetor 2001 u mbajtën zgjedhjet e para pas luftës për Kuvendin e Kosovës.<sup>7</sup> Në këto zgjedhje morën pjesë partitë politike të shqiptarëve dhe pakicave të tjera, duke garuar për 120 ulëse në Kuvend. Nga rezultati përfundimtar, Lidhja Demokratike e Kosovës fitoi 45.65% të votave (47 ulëse), Partia Demokratike e Kosovës 25.70% (26 ulëse), ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7.83% (8 ulëse). Po ashtu, pjesë e Kuvendit të Kosovës ishin edhe subjektet e tjera politike: Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) me një ulëse; Partia Demokratike Ashkali e Shqiptarëve të Kosovës (PDASHK) me dy ulëse; Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) me një ulëse; Koalicioni “Kthimi” (KK) me 22 ulëse, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PRBK) me një ulëse, Partia e Drejtësisë (PD) me një ulëse; Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) me një ulëse; Koalicioni “Vatan” (VTN) me katër ulëse; Partia e Aksionit Demokratike të Boshnjakëve të Kosovës (BSDAK - Bošnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova) me një ulëse; Partia Turke Demokratike e Kosovës (KDTP - Kosova Demokratik Türk Partisi) me një ulëse.<sup>8</sup>

Më 10 dhjetor 2001, nën drejtimin e Hans Hakerup, përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën, nisi punimet seanca e parë e legjislaturës së parë të Kuvendit të Kosovës, pas përfundimit të luftës çlirimtare të viteve 1998-1999.<sup>9</sup> Në këtë mbledhje, me 78 vota pro, 3 kundër dhe 2 abstenime, u zgjodh kryetar i Kuvendit akademik Nexhat Daci nga Lidhja Demokratike e Kosovës.<sup>10</sup> Më 4 mars 2002, në një mbledhje të Kuvendit, me 88 vota pro, 3 kundër dhe 15 abstenime, Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh president i Kosovës, ndërsa Bajram Rexhepi u emërua kryeministër, në një koalicion që përfshinte Lidhjen Demokratike të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe komunitete të tjera jo-shqiptare.<sup>11</sup>

<sup>6</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendet Komunale të Kosovës, f. 1. Për zgjedhjet në Kosovës, shih me gjerësisht: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet në Kosovë 2000-2014, Prishtinë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2017.

<sup>7</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet..., f. 14.

<sup>8</sup> Shih me gjerësisht: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet e vërtetuara, f. 1.

<sup>9</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal i seancës së Kuvendit të Kosovës mbajtur me 10 dhjetor 2001, f. 1.

<sup>10</sup> Po aty, f. 6.

<sup>11</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal i seancës së Kuvendit të Kosovës mbajtur me 04 mars 2002, f. 5.

Më 26 tetor të vitit 2002 u organizuan zgjedhjet e dyta për kuvendet komunale në gjithë territorin e Kosovës. Edhe këto zgjedhje i fitoi bindshëm Lidhja Demokratike e Kosovës, e drejtuar nga Dr. Ibrahim Rugova, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës e Hashim Thaçit dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e Ramush Haradinajt.<sup>12</sup> Më 23 tetor 2004 u organizuan zgjedhjet e dyta parlamentare për Kuvendin e Kosovës,<sup>13</sup> të cilat u mbajtën nën organizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me mbështetjen e UNMIK-ut dhe OSBE-së. Edhe në këto zgjedhje fituese u shpall Lidhja Demokratike e Kosovës e drejtuar nga Dr. Ibrahim Rugova, me 45.42% të votave (47 ulëse). Partia Demokratike e Kosovës fitoi 28.85% (30 ulëse), ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 8.39% (9 ulëse). Po ashtu, mbështetur në të dhënat zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës të mbajtura më 23 tetor 2004, pjesë e Kuvendit të Kosovës ishin edhe këto subjekte politike: Partia Reformiste “Ora” 7 ulëse; Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) dy ulëse; Partia Turke Demokratike e Kosovës (KDTP Kosova Demokratik Türk Partisi) një ulëse; Partia e Drejtësisë (PD) një ulëse; KV një ulëse; Lëvizja Popullore e Kosovës një ulëse; Partia Liberale e Kosovës një ulëse; Koalicioni “Kthim” 8 ulëse; KDTP dy ulëse; IRDK dy ulëse; GIS dy ulëse; Koalicioni “Vakat” një ulëse; Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës (PDAK) një ulëse; SDA një ulëse, GIG një ulëse; dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PRBK) një ulëse.<sup>14</sup>

Më 3 dhjetor 2004, nën drejtimin e deputetit më të vjetër të dalë nga zgjedhjet e tetorit, akademik Mark Krasniqi, u mbajt mbledhja inauguruese e legjislaturës së dytë të Kuvendit të Kosovës. Kjo mbledhje u bashkëkryesua edhe nga deputetja Nekibe Kelmendi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.<sup>15</sup> Në të njëjtën mbledhje, me 99 vota pro, 78 kundër dhe 3 abstenime, për kryetar të Kuvendit u zgjodh sërish akademik Nexhat Daci.<sup>16</sup> Po ashtu, me 64 vota pro dhe 32 kundër, për president të Kosovës u zgjodh Dr. Ibrahim Rugova.<sup>17</sup> Me propozimin e presidentit Rugova, me 72 vota pro, 2 kundër dhe 5

<sup>12</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultate e përfundimtare, Zgjedhjet 2002, f. 1-2.

<sup>13</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet..., f. 14.

<sup>14</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet 2004 - Rezultatet e zgjedhjeve të QNR (ulëset në Kuvend), f. 1-2.

<sup>15</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Transkript nga seanca solemne plenare e Kuvendit të Kosovës, e mbajtur me 03 dhjetor 2004, f. 1.

<sup>16</sup> Po aty, f. 8.

<sup>17</sup> Po aty, f. 34.

abstenime, u formua Qeveria e Kosovës e kryesuar nga kryeministri Ramush Haradinaj.<sup>18</sup>

Më 8 mars 2005, Ramush Haradinaj dha dorëheqje nga detyra e kryeministrit për shkak të një aktakuze nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës.<sup>19</sup> Kjo solli ndryshime në krye të Qeverisë, dhe me propozimin e tij, koalicioni Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës përzgjodhën Bajram Kosumin për kryeministër. Më 23 mars 2005, Kuvendi i Kosovës, mbështetur në propozimin e presidentit Dr. Ibrahim Rugova,<sup>20</sup> me 71 vota pro dhe 36 kundër, e zgjodhi Bajram Kosumin kryeministër.<sup>21</sup>

Në janar të vitit 2005, Grupi Ndërkombëtar i Krizave publikoi raportin e tij për Kosovën, ku theksohej se pavarësia është zgjidhja më e mirë.<sup>22</sup> Ky raport ndikoi në ndryshimin e ritmit të politikës në Prishtinë, si nga ana vendore, ashtu edhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Dr. Ibrahim Rugova themeloi Ekipin e Unitetit, që përbëhej nga udhëheqës kryesorë të institucioneve dhe përfaqësues politikë shqiptarë. Anëtarë të rëndësishëm të këtij ekipi ishin: Dr. Ibrahim Rugova, Nexhat Daci, Bajram Kosumi, Lutfi Haziri (ministër i Pushtetit Lokal), Hashim Thaçi (kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës), Veton Surroi (kryetar i Partisë Reformës “Ora”) dhe Blerim Shala (publicist).

Themelimi i Ekipit të Unitetit tregoi përkushtimin shtetëror dhe pjekurinë politike e largpamëse të Dr. Rugovës, i cili, megjithëse kishte besimin qytetar, ofroi bashkëpunim dhe kërkoi unitet politik përballë shtetit serb. Më 4 tetor 2005, ambasadori Kai Eide, i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Kofi Annan, i dorëzoi këtij të fundit raportin për Kosovën, ku kërkohesh nisja e negociatave mes Kosovës dhe Serbisë për statusin.<sup>23</sup> Raporti i ambasadorit Eide mbi situatën politike në Kosovë luajti një rol të rëndësishëm në nisjen e negociatave që përfunduan me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

<sup>18</sup> Po aty, f. 37.

<sup>19</sup> Tribunali Ndërkombëtar i Hagës, me akt gjykimin e tij të datës 29 nëntor 2012, e liro nga të gjitha akuzat e Prokurorisë Ramush Haradinaj ish komandant i Zonës Operativave të Rrafshit të Dukagjinit.

<sup>20</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Transkript nga seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, e mbajtur me 23-24 mars 2005, f. 4.

<sup>21</sup> Po aty, f. 34.

<sup>22</sup> International Crisis Group, Kosovo: Toward final status n°161 - 24 janar 2005, f. 1-37.

<sup>23</sup> Me gjerësisht për raportin e ambasadorit Kai Eide, shih: United Nations, Security Concile, S/2005/635, f. 1-23.

Në letrën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dërguar Këshillit të Sigurimit më 7 shkurt 2005, theksohej se ishin pjekur kushtet për nisjen e negociatave për statusin mes Serbisë dhe liderëve të Kosovës. Më 10 nëntor 2005, Këshilli i Sigurimit emëroi Martti Ahtisarin të dërguar special për statusin final të Kosovës,<sup>24</sup> ndërsa për zëvendës u emërua ambasadori austriak Albert Rohan. Ambasadori Rohan luajti një rol të rëndësishëm në proceset e paqes dhe në negociatat për statusin e Kosovës, duke mbështetur përpjekjet diplomatike të Ahtisarit dhe komunitetit ndërkombëtar për stabilitet në Ballkan.

Fillimi i vitit 2006 ishte sfidues për Kosovën. Më 21 janar 2006, në moshën 63 vjeçare, në Prishtinë ndërroi jetë presidenti i parë i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova. Vdekja e tij shkaktoi një boshllëk të madh brenda dhe jashtë Kosovës, në një kohë kur Kosova po afrohej drejt përcaktimit të statusit të saj. Gjithashtu, kjo vdekje nxiti ndasi edhe brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pas debatimeve të brendshme, Lidhja Demokratike kandidoi Fatmir Sejdiun, nënkryetar të Kuvendit, për president. Më 10 shkurt 2006, Kuvendi i Kosovës, me 80 vota pro, 10 kundër dhe 17 të pavlefshme, e zgjodhi Fatmir Sejdiun president.<sup>25</sup> Me ardhjen e tij në krye të vendit, presidenti Fatmir Sejdiu mori automatikisht kryesimin e Ekipit të Unitetit, të themeluar nga presidenti Dr. Ibrahim Rugova.

Më 10 mars 2006, Kuvendi i Kosovës, mbështetur në Kornizën Kushtetuese dhe me propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zëvendësoi Nexhat Dacin me deputetin Kolë Berisha si kryetar të Kuvendit. Në të njëjtën mbledhje, me propozimin e presidentit Fatmir Sejdiu dhe nominimin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, u zgjodh Qeveria e re e kryesuar nga Agim Çeku.<sup>26</sup>

Veçoria e kësaj Qeverie ishte themelimi i dy ministrive të reja brenda Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës (IPVQ): Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të cilat morën kompetenca të kufizuara nga UNMIK-u. Bisedimet e Vjenës për statusin përfundimtar ngushtoheshin në kohë dhe hapësirë mes palëve. Më 24 korrik 2006, në pallatin Niederösterreich në Vjenë, u mbajt një takim i nivelit më të lartë mes

<sup>24</sup> Më 21 nëntor 2005, Martti Ahtisaari, si i dërguar i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, vizitoi Prishtinën. Ai zhvilloi takime të ndara me presidentin e Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, kryeministrin e Kosovës, Bajram Kosumi, kryeadministratorin e Kosovës, Søren Jessen-Petersen, përfaqësuesit e partive opozitare, si dhe ata të komunitetit serb.

<sup>25</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal nga seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, e mbajtur më 10 shkurt 2006, f. 1-4.

<sup>26</sup> Po aty, f. 45.

Kosovës dhe Serbisë, me pjesëmarrjen e presidentit Fatmir Sejdiu dhe kryeministrit Agim Çeku për Kosovën, si dhe presidentit Boris Tadić dhe kryeministrit Vojislav Koštunica për Serbinë. Martti Ahtisari dhe ekipi i tij punonin sipas udhëzimeve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe koordinonin me shtetet kryesore vendimmarrëse. Më 26 janar 2007, Ahtisari takoi anëtarët e Grupit të Kontaktit (SHBA, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Itali dhe Rusi). Më 2 shkurt 2007, ai dorëzoi propozimin e tij për statusin në Beograd dhe Prishtinë. Plani i tij parashihte një pavarësi të mbikëqyrur të Kosovës, me një fazë kalimtare të kontrolluar nga një përfaqësues civil ndërkombëtar.<sup>27</sup>

Publikimi i Planit të Ahtisarit ishte një moment historik për Kosovën, megjithëse në disa pika ishte një kompromis i dhimbshëm për Kosovën në raport me komunitetin serb. Megjithatë, shumica e udhëheqësve dhe popullsisë e konsideruan këtë rrugën e vetme drejt pavarësisë, ëndërruar prej brezash të tërë. Një pakicë e vogël, kryesisht Lëvizja Vetëvendosje dhe udhëheqësi i saj Albin Kurti, e kundërshtuan planin. Kjo organizatë, e themeluar nga Kosova Action Network (KAN), organizoi më 10 shkurt 2007 një demonstratë masive në Prishtinë, ku rreth 50 mijë persona brohoritën “Jo negociata - Vetëvendosje!”. Demonstrata u shoqërua me dhunë, njësitë e policisë së UNMIK-ut përdorën gaz lotsjellës dhe dhunë të tepruar. Si pasojë e dhunës së përdorur nga policia e UNMIK-ut, u vranë dy demonstrues, Arben Xheladini dhe Mon Balaj, si dhe u plagosën 73 të tjerë.

Pas dhunës së përdorur nga njësitë policore të UNMIK-ut, ministri i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, Fatmir Rexhepi, dha dorëheqje të parevokueshme. Demonstrata u cilësua nga faktori ndërkombëtar si jo e nevojshme, ndërsa faktori politik i brendshëm akuzoi organizatorët për pengimin e zgjidhjes përfundimtare të statusit. Pas dorëzimit të Planit të Ahtisarit te pala shqiptare dhe serbe, si dhe pas demonstratave të Vetëvendosjes, politika zyrtare në Prishtinë u aktivizua.

Më 5 prill 2007 u mbajt një seancë plenare e Kuvendit të Kosovës, ku morën pjesë deputetët, presidenti Fatmir Sejdiu, Ekipi i Unitetit dhe Qeveria. Seancën e hapi kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha, i cili theksoi se plani i Ahtisarit ishte i mirëpritur dhe mbështetej nga SHBA, Bashkimi Evropian, vendet e tjera dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon. Ai nënvizoi

<sup>27</sup> Rreth përmbajtjes së Planit të Ahtisarit për pavarësinë e Kosovës, shih me gjerësisht: United Nations, Security Council, S/2007/168/Add.1, Letter dated 26 March 2007 from the Secretary-General addressed to the President of the Security Council, Addendum: Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement, f. 1-64.

edhe fjalimin e presidentit Sejdiu të mbajtur më 3 prill 2007 para Këshillit të Sigurimit.<sup>28</sup> Pas fjalëve të kryetarit Berisha, deputetëve iu drejtuan presidenti Fatmir Sejdiu, kryeministri Agim Çeku, Hashim Thaçi dhe Veton Surroi, anëtarë të Ekipit të Unitetit.<sup>29</sup> Në fund, kryetari Berisha lexoi Deklaratën e Kuvendit për mbështetjen e Raportit dhe Propozimit gjithëpërfshirës të Martti Ahtisarit për statusin e Kosovës. Deklarata ishte harmonizuar nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, përveç atyre serbe.

Në deklaratë thuhej, ndër të tjera:

“Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj deklarate, mirëpret raportin final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, duke besuar se rekomandimet e tij paraqesin një zgjidhje të drejtë dhe të balancuar, që është në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës.

Pranon dhe zotohet të implementojë plotësisht Propozimin gjithëpërfshirës të marrëveshjes për statusin e Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars të vitit 2007 dhe deklaron, nën supozimin që Marrëveshja është e pranueshme për Këshillin e Sigurimit, se dispozitatat që i përmban marrëveshja do të jene ligjërish të obligueshme për Kosovën.

Mirëpret pa rezervë praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë që do të krijohet në Kosovë, siç parashihet në Marrëveshje dhe zotohet se do të bashkëpunojë dhe do ta mbështes këtë prani në çdo mënyrë të mundshme, përderisa kjo prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë t’i kryejë detyrat që i janë dhënë në Marrëveshje”. Kjo deklaratë u miratua me shumicë absolute të votave, ku vetëm një votë ishte kundër.<sup>30</sup>

Më 17 nëntor 2007, nën organizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përkrahur nga misioni i OSBE-së, në Kosovë u zhvilluan zgjedhjet e treta komunale, si dhe, për herë të parë, këto zgjedhje u mbajtën në dy nivele: në nivelin për kryetar të komunës dhe për anëtarë të kuvendeve komunale. Ndërsa, rundi i dytë për kryetarët e komunave u mbajt më 8 dhjetor 2007.<sup>31</sup>

<sup>28</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Transkripti i seancës plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur me 5 prill 2007, f. 2.

<sup>29</sup> Po aty, f. 3-7.

<sup>30</sup> Po aty, f. 7-8.

<sup>31</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zgjedhjet në Kosovë 2000-2014, Prishtinë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2017, f. 14.

Edhe në këto zgjedhje, rezultati për udhëheqësit e komunave u nda mes Lidhjes Demokratike të Kosovës, të drejtuar nga Fatmir Sejdiu, Partisë Demokratike të Kosovës, të drejtuar nga Hashim Thaçi, dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të drejtuar nga Ramush Haradinaj.

### **Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008**

Pas dorëzimit dhe publikimit të Planit të Ahtisarit sa i takon statusit përfundimtar të Kosovës, vendet më të fuqishme demokratike të botës i dhanë përkrahje këtij dokumenti, por ishin vetëm serbët, të përkrahur edhe nga politika zyrtare e Moskës dhe Pekinit, që kundërshtuan dhe ishin kundër Planit të Ahtisarit. Situata e brendshme në Kosovë, edhe pse kishte prani civile, ushtarake dhe policore ndërkombëtare, ishte e brishtë. Institucioneve të dala nga zgjedhjet e tetorit të vitit 2004, mbështetur në Kornizën Kushtetuese dhe ligjet e tjera të Kosovës, u përfundoi mandati.

Më 17 nëntor të vitit 2007, nën organizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Për herë të parë që nga përfundimi i luftës për çlirimin e Kosovës të viteve 1998-1999, partia e parë fituese në vend doli një subjekt politik i themeluar pas luftës nga përfaqësues që ishin pjesë aktive apo tërthorazi e luftës për çlirimin e Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës, e drejtuar nga Hashim Thaçi, i fitoi 34.3% të votave, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila udhëhiqej nga Fatmir Sejdiu dhe e cila fitoi 22.6% të votave. Aleanca Kosova e Re, e drejtuar nga Behxhet Pacolli, i fitoi 12.3% të votave, Lidhja Demokratike e Dardanisë, e udhëhequr nga akademik Nexhat Daci, në koalicion me Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, të drejtuar nga Mark Krasniqi, mori 10.0% të votave, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e udhëhequr nga Ramush Haradinaj<sup>32</sup> fitoi 9.6% të votave. Jashtë Kuvendit të Kosovës mbeti Partia Reformiste “Ora”, e drejtuar nga Veton Surroi, e cila mori vetëm 4.1%, si dhe Partia e Drejtësisë e drejtuar nga Sulejman Çerkezi, e cila mori 1.7% të votave. Partitë tjera që u bënë pjesë e Kuvendit të Kosovës ishin: KDTP një ulëse, PDAK tri ulëse, VAKAT tri ulëse, SLS tri ulëse, SDSKM tri ulëse, SDA dy ulëse, SNS një ulëse, Nova Demokratija një ulëse, GIG një ulëse, SKMS një ulëse, IRDK një ulëse, SNSDKM një ulëse, dhe PREBK një ulëse.<sup>33</sup>

<sup>32</sup> Ramush Haradinaj nuk mori pjesë në zgjedhje për shkak se ndodhej në proces gjyqësor pranë Tribunalit të Hagës.

<sup>33</sup> Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Përqindja e votave, f. 1.

Pas bisedave ndërpartiake, si dhe nxitjes nga faktori ndërkombëtar, meqë Kosova ndodhej para fazës finale të përcaktimit të statusit të saj, Partia Demokratike e Kosovës ftoi në bashkëqeverisje Lidhjen Demokratike të Kosovës. Në bazë të marrëveshjes, posti i kryetarit të Kuvendit dhe ai i kryeministrit të Kosovës i takonin Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa posti i presidentit të Kosovës i takonte Lidhjes Demokratike të Kosovës. Nga 15 ministri, Partia Demokratike e Kosovës i mori 7 ministri dhe 1 post të zëvendëskryeministrit, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës mori 5 ministri dhe 1 post të zëvendëskryeministrit. Dy ministri i morën komuniteti serb dhe një ai turk.

Themelimi i institucioneve të brendshme në Kosovë, pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, u zhvillua në një situatë shumë të brishtë politike. Kjo situatë ishte pasojë e ngjarjeve të brendshme, veçanërisht pas vdekjes së presidentit Dr. Ibrahim Rugova, i cili kishte lënë një boshllëk të madh në procesin e negociatave që kishin hyrë në fazën përfundimtare për statusin final të Kosovës.

Në këtë situatë, brishtësia politike u thellua edhe më tej nga ndasitë e brendshme, të cilat u reflektuan në ndryshimet në Presidencë, Kuvend dhe Qeveri, duke e bërë tejkalimin e situatës sfidues dhe të vështirë për aktorët politikë. Një pjesë e rëndësishme e kësaj situatë ishte edhe përçarja brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së presidentit të ndjerë Rugova. Një grup anëtarësh, të pakënaqur me zgjedhjen e Fatmir Sejdiut si kryetar i LDK-së dhe nën drejtimin e Nexhat Dacit, u shkëputën duke themeluar Lidhjen Demokratike të Dardanisë. Kjo nuk ishte ndarja e parë brenda LDK-së; ndarja e madhe kishte ndodhur më 25 shkurt 1998, kur një grup kryesisht i përbërë nga të burgosur politikë u shkëput dhe krijoi Lëvizjen për Bashkim Demokratik, të udhëhequr nga shkrimtari Rexhep Qosja.

Ndarja e re dhe themelimi i Lidhjes Demokratike të Dardanisë patën ndikim të menjëhershëm në rezultatet zgjedhore. LDK-ja humbi epërsinë që kishte pasur për vite me radhë dhe doli e dyta në zgjedhjet e nëntorit 2007. Kjo i hapi rrugën fitores së Partisë Demokratike të Kosovës, të udhëhequr nga Hashim Thaçi. Për herë të parë pas përfundimit të luftës, pushteti iu besua një grupi politik me lidhje të ngushta apo tërthorazi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke shënuar kështu një fazë të re në historinë politike të Kosovës së pasluftës. Më 4 janar 2008 nisi punën seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës. Fillimisht u themelua Komisioni për Imunitete dhe Mandate, i cili kishte për detyrë të verifikonte mandatet e të zgjedhurve të popullit. Më pas, një fjalë rasti e mbajti edhe Joachim Rücker, kryeadministratori i Kosovës.

Pas fjalës së shefit të UNMIK-ut, Kuvendi vijoi punimet me miratimin e Raportit të Komisionit për Imunitete dhe Mandate.

Në vazhdim të seancës, me 88 vota pro dhe 1 kundër, deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjodhën për kryetar Jakup Krasniqin.<sup>34</sup> Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit u zgjodhën: Xhavit Haliti nga Partia Demokratike e Kosovës; Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu nga Lidhja Demokratike e Kosovës; Ibrahim Gashi nga Aleanca Kosova e Re; dhe Nexhat Daci nga Lidhja Demokratike e Dardanisë.<sup>35</sup> Pas zgjedhjes së kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, deputetët vazhduan seancën me zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Me propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në raundin e tretë të votimit, Fatmir Sejdiu u zgjodh në detyrën e presidentit të Kosovës, duke marrë 68 vota pro.<sup>36</sup> Pas zgjedhjes së Fatmir Sejdiut si president i Kosovës, dhe në përputhje me Kornizën Kushtetuese dhe marrëveshjen për bashkëqeverisje mes Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, u dekretua Hashim Thaçi për detyrën e kryeministrit të Kosovës. Kështu, më 9 janar të vitit 2008, në vazhdim të seancës së 4 janarit, me 85 vota pro, 22 kundër dhe 4 abstenime, deputetët e Kuvendit zgjodhën Hashim Thaçin për kryeministër të Qeverisë së Kosovës.<sup>37</sup>

Pas një koordinimi me fuqitë perëndimore, më 17 shkurt 2008, institucionet e Kosovës u vunë në veprim konkret për të shpallur pavarësinë e Kosovës. Pas koordinimit të presidentit Fatmir Sejdiu, kryetarit të Kuvendit Jakup Krasniqi dhe kryeministrit Hashim Thaçi, u thirr seanca e Kuvendit të Kosovës në ditën e diel, më 17 shkurt 2008, në ora 15:00. Kjo seancë u thirr pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.<sup>38</sup>

Në bazë të procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ku merrnin pjesë kryetarët e grupeve parlamentare, presidenti, kryeministri dhe një numër i stafit mbështetës, kuptojmë se seanca e Kuvendit të Kosovës, e paraparë për orën 15:00, është thirrur me kërkesë të presidentit dhe kryeministrit të Kosovës.<sup>39</sup> Seanca e Kuvendit të Kosovës nisi në orën 15:00, nën

<sup>34</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës të mbajtur me 04 dhe 09 janar 2008, f. 1-13.

<sup>35</sup> Po aty, f. 6.

<sup>36</sup> Po aty, f. 8.

<sup>37</sup> Po aty, f. 10-11.

<sup>38</sup> Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal i Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentar, të mbajtur me 17 shkurt 2008, f. 1-3.

<sup>39</sup> Shih me gjerësisht: Arkivi i Kuvendit të Kosovës, Procesverbal i Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentar, të mbajtur me 17 shkurt 2008, f. 1-3.

drejtimin e kryetarit të Kuvendit, Jakup Krasniqi. Në këtë seancë morën pjesë edhe kreu i Kosovës, presidenti Fatmir Sejdiu, kryeministri Hashim Thaçi me ministrat e tij, si dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, përjashtuar ata të komunitetit serb.

Në fjalën e tij, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, si folës i parë në këtë seancë, theksoi: *“Kosova po hap sot një faqe të re të historisë dhe po ndërron hartën politike të Evropës. Duke lënë pas kujtimet e hidhura të urrejtjes e të konflikteve tragjike që i përjetuam, ne po hyjmë në epokën e pavarësisë, të paqes dhe të përparimit të vendit tonë. Paqe dhe liri të vërtetë mund të ketë vetëm midis të barabartëve. Kosova e pavarur do të jetë atdheu i qytetarëve të barabartë e të lumtur, duke u ngritur mbi themelet e vlerave më të mira të traditës së saj dhe sipas parimeve të demokracisë moderne. Brezi i sotëm i Kosovës ka privilegj të veçantë për kthesën e madhe historike që i bën nder, por bashkë me të ka edhe përgjegjësinë e lartë të ndërtimit demokratik e evropian të atdheut dhe të brezave që do të na trashëgojnë.*

*Zotimi ynë solemn për Kosovën shtet demokratik është kontrata me qytetarët e saj dhe partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare, është premtimi i përkushtimit jetësor për vlerat më të përparuara e themeltare të shoqërisë së sotme njerëzore. Kosova, asnjëherë në jetën e saj nuk ka pasur miq sa ka sot. Por, nesër do të ketë edhe më shumë. Kultura dhe rendi demokratik, shteti ligjor, përkushtimi paqekrijues, fqinjësia e mirë dhe fryma e dialogut, respekti dhe besimi - do të jenë baza e zgjerimit të miqësisë dhe të bashkëpunimit e të partneritetit. Shfrytëzoj këtë rast solemn të shpreh ndjenjat e përuljes së popullit të Kosovës ndaj të gjithë atyre që u flijuan në altarin e lirisë së Kosovës. Me respekt të veçantë përshëndes të gjithë miqtë tanë që me përkushtim ndihmuan Kosovën në çastet vendimtare dhe historike. Populli shqiptar dhe qytetarët e Kosovës do t’u jenë mirënjohës për jetë.”*<sup>40</sup> Kështu, ndër të tjera, u shpreh kryetari Krasniqi në fjalën e tij hyrëse.

Më pas, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, paraqiti rendin e ditës, ku pika e parë ishte deklarata për pavarësi dhe pika e dytë miratimi i simboleve shtetërore. Fillimisht, rendin e ditës e miratuan 104 deputetë të Kuvendit, ndërsa pak më vonë në sallë u bashkuan edhe 5 deputetë të tjerë, duke u bërë gjithsej 109 deputetë prezentë në sallë.<sup>41</sup> Pas miratimit të rendit të ditës,

<sup>40</sup> Arkivi i Kuvendit të Republikës së Kosovës: Transkript nga seanca plenare e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës me rastin e shpalljes së pavarësisë, të mbajtur më 17 shkurt 2008, f. 2.

<sup>41</sup> Po aty, f. 3.

kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ftoi kryeministrin Hashim Thaçi që të bëjë arsyetimin e thirrjes së seancës jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës. Më pas, në foltoren e Kuvendit fjalën e mori kryeministri Thaçi, i cili theksoi se: *“Sot, në bashkëpunim me Presidentin e Kosovës, si Kryeministër i Kosovës, kam kërkuar zyrtarisht nga Kryetari i Parlamentit zoti Krasniqi, që ta thërret seancën e jashtëzakonshme me dy pika të rendit të ditës.*

*Ftesa për seancë të jashtëzakonshme është bërë në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe kërkesa jonë ka qenë për dy pika të rendit të ditës: 1. Shpallja e pavarësisë së Kosovës, dhe 2. Nxjerrja e simboleve shtetërore të Kosovës. Faleminderit zoti Kryetar për thirrjen me urgjencë dhe aprovimin e menjëhershëm nga Kryesia e Parlamentit dhe për miratimin e këtij rendi të ditës. Prandaj, të vazhdojmë”.*<sup>42</sup> Pas fjalës së kryeministrit Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit ia dha fjalën presidentit Fatmir Sejdiu.

Para deputetëve të Kuvendit, anëtarëve të Qeverisë dhe korit diplomatik ndërkombëtar, presidenti i Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, nga foltorja e Kuvendit, si kreu i shtetit, theksoi: *“Dita e sotme e ndanë historinë e Kosovës në dysh: në epokat para dhe pas pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës e kanë krijuar breza të tërë me veprën e tyre jetësore, me punë të palodhshme dhe me sakrificat që kanë bërë. Pavarësinë tonë po e shpallim para dhe me bekimin e botës, në mes miqsh tanë që u gjetën pranë nesh gjatë dekadave e sidomos para një dekade, kur e keqja kishte përfshirë këtë pjesë të Ballkanit. Po të njëjtit miq ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi. Janë edhe sot, janë edhe nesër. Sot, kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme. I kujtojmë nënat dhe baballarët të cilët përjetuan vështirësi të papërshkrueshme në mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Sot, kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqësin e madh dhe themelтарin e shtetit tonë, i cili e nxori Kosovën nga kaosi në rend demokratik. Sot, kujtojmë Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e çuan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Po ashtu kujtojmë edhe fqinjët tanë të gjitha përkatësive etnike, ideologjike e religjioze të cilët na dolën në ndihmë gjatë viteve të represionit dhe luftës. I kujtojmë të gjitha këto jo në shenjë hakmarrjeje për të kaluarën e dhunshme, por për të ndërtuar një të ardhme plot besim që do të ofrojë ambient për pajtim dhe falje”,* tha presidenti Sejdiu, duke shtuar se: *“Pavarësia e Kosovës shënon fundin e procesit të gjatë të*

<sup>42</sup> Po aty, f. 8-9.

*shpërbërjes së Jugosllavisë. Pas dy vitesh angazhimi në negociata të mirëfillta mbi statusin me Beogradin dhe përkundër angazhimit serioz dhe konstruktiv të Ekspertit të Unitetit të Kosovës, arritja e një zgjidhjeje të pranueshme për dy palët nuk ishte e mundshme. Prandaj, u desh të vepronim për t'i ofruar popullit tonë një perspektivë të qartë me qëllim të avancimit të zhvillimit tonë politik, shoqëror dhe ekonomik. Vizioni ynë për Kosovën është shumë i qartë. Dëshirojmë që Kosovën ta ndërtojmë mbi parimet fundamentale demokratike. Kjo do të thotë se Kosova do të jetë një shtet demokratik, shumetnik, i integruar në rajon, me marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet përreth, një shtet që lëviz shpejt drejt anëtarësimit të plotë në Bashkësinë Euro-atlantike. Populli i Kosovës është përcaktuar dhe dëshiron një të ardhme evropiane për vendin e vet.*"<sup>43</sup>

Në vazhdim të adresimit të tij para Kuvendit të Kosovës, presidenti Dr. Sejdiu theksoi vendosmërinë e Kosovës për garantimin e të drejtave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, pa përjashtuar asnjë, duke nënvizuar fuqishëm se: *"Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës në mars të vitit të kaluar ka marrë edhe përkrahjen e Kuvendit të Kosovës. Kjo pako iu jep serbëve por edhe pakicave tjera: turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve, garanci të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të tyre kulturore e politike, që në shumë pika tejkalojnë edhe standardet më të avancuara ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve pakicë pjesëmarrje të gjithanshme dhe kuptimplote në vendimmarrje.*"<sup>44</sup>

Pas fjalës së presidentit Fatmir Sejdiu, kryetari i Kuvendit ia dha fjalën kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, për të paraqitur propozim-deklaratën për pavarësinë e Kosovës. Me këtë rast, ai ftoi të pranishmit të ngriheshin në këmbë. Pasi doli në foltoren e Kuvendit të Kosovës, kryeministri Hashim Thaçi, pasi përshëndeti kryetarin e Kuvendit, presidentin, deputetët, mysafirët, familjen Jashari e familjen Rugova dhe falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe Bashkimin Evropian, duke theksuar se ndihej i privilegjuar, nisi të lexojë Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës:

<sup>43</sup> Po aty, f. 8-9.

<sup>44</sup> Po aty, f. 9.

## **DEKLARATË PËR PAVARËSINË E KOSOVËS**

*Të mbledhur në Seancë solemne plenare të jashtëzakonshme, më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës,*

*Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj;*

*Të zotuar për t'u përballur me trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt dhe në frymë të pajtimit dhe të faljes;*

*Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë;*

*Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen Euro-atlantike të demokracive;*

*Duke vërejtur se Kosova është një rast i veçantë që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është precedencë për cilëndo situatë tjetër;*

*Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe të dhunës në Kosovës, që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar;*

*Duke qenë mirënjohës ndaj gjithë botës që ndërhyri me 1999, duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën dhe duke vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara;*

*Duke qenë krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale shumetnike të demokracisë, që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë;*

*Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara nga ndërkombëtarët ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik;*

*Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dy palët, përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqjes kosovare dhe rolit të rëndësishëm ndërkombëtar;*

*Duke rikonfirmuar se rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Presidentit Martti Ahtisaari, i ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, janë në një vijë me standardet më të larta evropiane për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë;*

*Duke qenë të vendosur që të shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jepet popullit tonë qartësi për të ardhmen dhe të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potencial i plotë demokratik i shoqërisë sonë;*

*Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,*

1. *Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj DEKLARATE SHPALLIM KOSOVËN SHTET TË PAVARUR DHE DEMOKRATIK.*

*Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe propozimin e tij gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ne e shpallim Kosovën Republikë demokratike, laike dhe shumetnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe të mbrojtjes së barabartë sipas ligjit.*

*Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe do të krijojmë kushte të nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.*

*Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën që përmban plani i Ahtisaarit dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim.*

*Ne do t'i zbatojmë plotësisht ato obligime dhe miratimin prioritar të legjislacionit, të përfshirë në Aneksin 12 të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre.*

*Ne do të miratojmë, sa më shpejt që është e mundur, një Kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Kushtetuta do të përfshijë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.*

*Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1999.*

*Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision për sundimin e ligjit, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian.*

*Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë me përgjegjësi të dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999, dhe Planit të Ahtisaarit deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi.*

*Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, përparimin, stabilitetin për të ardhmen e Kosovës.*

*Për arsye të kulturës, të gjeografisë dhe të historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane.*

*Andaj, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian, sapo që të jetë e mundshme, dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik.*

*Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas luftime dhe në ndërtimin e institucioneve të demokracisë.*

*Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, derisa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.*

*Me pavarësinë vjen detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'u përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktit final të Helsinkit, akteve të tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhënie ndërmjet shteteve.*

*Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë, ashtu siç janë paraparë në Aneksin 8 të Planit të Ahtisarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të gjithë fqinjëve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.*

*Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë – UNMIK, si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet e tjera të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ndaj të cilave obligohemi si ish pjesë konstituive, përfshirë Konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore.*

*Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish – Jugosllavinë.*

*Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllimet e paqes dhe të stabilitetit ndërkombëtar.*

*Kosova zotohet për paqe dhe stabilitet në rajonin tonë dhe në Evropën Juglindore.*

*Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të mundësonte Evropën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit.*

*Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për ta avancuar të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.*

*Ne shprehim në veçanti dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë në të ardhmen e afërt.*

*Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'iu kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në bashkëpunim me Republikën e Serbisë, duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.*

*Ne konfirmojmë, në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërish e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit.*

*Në të gjitha këto çështje ne do të veprojmë në pajtueshmëri me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244, viti 1999.*

*Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështesin këtë Deklaratë dhe u bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.”<sup>45</sup>*

Ky ishte fjalimi i kryeministrit Hashim Thaçi, teksa e përfundoi duke falënderuar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Pas leximit të propozim-deklaratës për pavarësinë e Kosovës nga ana e kryeministrit Hashim Thaçi, fjalën e mori kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, i cili theksoi se në sallë ndodheshin 109 deputetë. Me kërkesë të deputetëve, votimi u krye me ngritje dore.<sup>46</sup>

Më pas, kryetari i Kuvendit ftoi deputetët që të votonin për propozim-deklaratën që e lexoi kryeministri Thaçi. Pas duartrokitjeve, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, theksoi: “Konstatoj se me të gjitha votat “për” të deputetëve të pranishëm, deputetët e Kuvendit të Kosovës, sot, më 17 shkurt 2008, shprehën vullnetin e tyre dhe përmes tyre, edhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.”<sup>47</sup>

Kështu, të 109 deputetët e Kuvendit të Kosovës të pranishëm në seancën e jashtëzakonshme, miratuan njëzëri Deklaratën dhe shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.<sup>48</sup>

<sup>45</sup> Po aty, f. 11-15.

<sup>46</sup> Po aty, f. 15.

<sup>47</sup> Po aty.

<sup>48</sup> Po aty.

Më pas, fjalën e mori Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, i cili ftoi që Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës ta nënshkruanin presidenti, kryetari i Kuvendit dhe kryeministri.<sup>49</sup> Duhet theksuar se në një tavolinë të posaçme të vendosur para foltres së Kuvendit, u vendos Deklarata për Pavarësinë e Kosovës, e cila pas leximit dhe miratimit, u nënshkrua fillimisht nga presidenti Fatmir Sejdiu, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi dhe kryeministri Hashim Thaçi. Më pas, nënshkrimi i Deklaratës vazhdoi nga nënkryetarët e Kuvendit dhe figura të tjera të rëndësishme politike, duke shënuar kështu një moment historik për Kosovën.

I pari që firmosi Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës ishte presidenti Fatmir Sejdiu, pas tij e nënshkroi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, dhe më pas kryeministri Hashim Thaçi.<sup>50</sup>

Presidenti Sejdiu, kryetari i Kuvendit Krasniqi dhe kryeministri Thaçi qëndronin të ulur para foltres së Kuvendit, në tavolinën ku ishte vendosur Deklarata për Pavarësi. Pas nënshkrimit të tyre, deklarata nisi të nënshkruhej edhe nga nënkryetarët e Kuvendit.

Pas Xhavit Halitit, seancën e drejtuan nënkryetari tjetër i Kuvendit, Ibrahim Gashi, i cili ftoi që Deklaratën për Pavarësi ta firmosnin edhe Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu.<sup>51</sup> Pas drejtimit të seancës nga ana e Ibrahim Gashit, drejtimin e mori Xhavit Haliti, i cili ftoi për nënshkrim Ibrahim Gashin, Nexhat Dacin, Naim Malokun e Xhezair Muratin.<sup>52</sup> Pas nënshkrimit të Deklaratës nga ana e nënkryetarëve të Kuvendit, nënshkrimi vijoi nga kryetarët e grupeve parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Zylfi Merxha.<sup>53</sup> Pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, nënshkrimi vazhdoi nga deputetët e pranishëm, disa prej të cilëve mbanin edhe poste në qeveri: Adem Grabovci, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Agim Veliu, Ahmet Isufi, Ali Lajçi, Alush Gashi, Anita Morina-Saraçi, Armend Zemaj, Arsim Bajrami, Arsim Rexhepi, Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Behgjet Pacolli, Berat Luzha, Berim Ramosaj, Besa Gaxherri, Bujar Bukoshi, Donika Kadaj, Drita Kadriu, Drita Maliqi, Driton Tali, Edita Tahiri, Elheme Hetemi, Emrush Xhemajli, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Esat Brajshori, Etem Arifi, Ethem Çeku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fat-

<sup>49</sup> Po aty, f. 16.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Po aty.

<sup>53</sup> Po aty.

mire Berisha, Fehmi Mujota, Flora Brovina, Gani Buçinca, Gani Geci, Gani Koci, Gjylnaze Sylja, Hafize Hajdini,<sup>54</sup> Hajdin Abazi, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuçi, Haki Shatri, Heset Cakolli, Hydajet Hyseni, Ibrahim Selmanaj, Ismet Beqiri, Kaçusha Jashari, Kolë Berisha,<sup>55</sup> Luljeta Shehu, Lutfi Haziri, Mahir Yagcilar, Mark Krasniqi, Melihate Tërmkolli, Memli Krasniqi, MIMOZA Ahmetaj, Mufera Shinik, Myrvete Pantina, Myzejene Selmani, Naim Rrustemi, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Numan Balić, Nurishahe Hulaj, Njomza Emmini, Qamile Morina, Ramadan Avdiu, Ramadan Gashi, Ramë Manaj, Rasim Selmanaj, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Rrustem Mustafa, Sabit Rrahmani, Sadik Idriz, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sanije Aliaj, Selvije Halimi, Skender Hyseni, Suzan Novobërdaliu, Synavere Rysha, Shkumbin Demalijaj, Shpresa Murati, Teuta Hadri, Vezira Emrush, Vlora Çitaku, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Zef Morina dhe Zylfije Hundozi.<sup>56</sup>

Pra, nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit të Kosovës, të legjislaturës së tretë, 109 prej tyre nënshkruan Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008. Në këtë seancë munguan deputetët e komunitetit serb dhe një deputet nga komuniteti goran.<sup>57</sup> Pas nënshkrimit të Deklaratës, seanca vazhdoi me pikën e dytë, ku u miratuan stema dhe flamuri i Republikës së Kosovës.<sup>58</sup> Stema e Republikës së Kosovës e cila u miratua është simbol zyrtar shtetëror që përfaqëson sovranitetin dhe identitetin kombëtar. Në qendër të stemës ndodhet një skicë e konturit të Kosovës në ngjyrë të artë mbi një fushë blu. Përmbi hartën janë gjashtë yje të bardhë të renditur në formë harku. Ndërsa, flamuri i Republikës së Kosovës është i përbërë nga një fushë blu me hartën e Kosovës me ngjyrë të artë në qendër. Mbi hartë janë gjashtë yje të bardhë. Pas shpalljes së stemës dhe flamurit, kryetari i Kuvendit urdhëroi që flamuri

<sup>54</sup> Seancën e nisi dhe e drejtoi Ibrahim Gashi, nënkryetar i Kuvendit.

<sup>55</sup> Seancën e nisi dhe e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

<sup>56</sup> Arkivi i Kuvendit të Republikës së Kosovës: Transkript nga seanca plenare e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës me rastin e shpalljes së pavarësisë, të mbajtur më 17 shkurt 2008, f. 16-21.

<sup>57</sup> Deputetët serbë dhe ai i komunitetit goran që munguan në seancën e Kuvendit të Kosovës më 17 shkurt 2008 ishin: Bojan Stojanović, Branislav Gërbiq, Dragisha Miriq, Kosara Nikoliq, Ljubisha Zhiviq, Mihajlo Shqëpanović, Radmila Vujović, Slavisha Petković, Slobodan Petroviq, Vladimir Todorović dhe Mursel Halili. Shih me gejrëishtë: Arkivi i Kuvendit të Republikës së Kosovës: Transkript nga seanca plenare e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës me rastin e shpalljes së pavarësisë, të mbajtur më 17 shkurt 2008, f. 16-21.

<sup>58</sup> Po aty, f. 22.

të vendosej në ballin e sallës së Kuvendit.<sup>59</sup> Me këtë akt u mbyll seanca e Kuvendit të Kosovës, nga e cila u shpall pavarësia.<sup>60</sup>

Në kuadër të themelimit të korpusit të simboleve që përcaktojnë identitetin shtetëror të Kosovës, Deklarata e Pavarësisë zë një vend qendror si dokument themelor me rëndësi të jashtëzakonshme historike, politike dhe të trashëgimisë kulturore. Ekspoziti muzeal i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, i realizuar në pergamenë, u konceptua dhe u realizua nën udhëheqjen e Prof. Arbër Hadri, në kuadër të institucionit të Muzeut të Kosovës, ku ai shërbeu si drejtor. Realizimi i Deklaratës së Pavarësisë u përkrah gjithashtu përmes bashkëpunimit profesional nga ana e Muzeut të Londrës, duke rezultuar në një nga ekspozitat më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore të Kosovës, me vlerë të lartë artistike dhe me përmasa ndërkombëtare. Teksti i Deklaratës është bukurshkruar në pergamenë nga profesori i mirënjohur Shyqyri Nimani. Zgjedhja e pergamenës, si material me qëndrueshmëri të lartë dhe rezistencë afatgjatë ndaj faktorëve të degradimit, e pozicionon këtë dokument si artefakt me vlerë të veçantë simbolike dhe memoriale.

Në këtë kuptim, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës përfaqëson një margaritar të çmuar të trashëgimisë kulturore kombëtare, i cili kërkon ruajtje dhe prezantim në përputhje me standardet më të larta të konservimit muzeor. Në të njëjtin kontekst shtetformues, flamuri i Kosovës është konceptuar nga dizajneri grafik Muhamer Ibrahim, ndërsa himni shtetëror është kompozuar nga Prof. Mendi Menxhiqi, duke plotësuar kështu arkitekturën e simboleve të identitetit shtetëror të Kosovës.

Në të gjitha qytetet e Kosovës, që në mëngjesin e ditës së dielë, më 17 shkurt 2008 nisën festimet, të cilat morën jehonë gjithandej. Pas shpalljes së

<sup>59</sup> Pas proklamimit me vendosmëri nga Ilir Gashi, flamuri u vendos në ballë të sallës së Kuvendit, duke simbolizuar rëndësinë e këtij momenti historik për Kosovën. Ilir Gashi ishte pjesë e stafit të Zyrës së Kryetarit të Kuvendit.

<sup>60</sup> Më 20 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës i miratoi këto ligje: 1. Ligjin për privilegjet dhe imunitetet diplomatike, 2. Ligjin për shtetësinë, 3. Ligjin për policinë, 4. Ligjin për Inspektoratin Policor, 5. Ligjin për dokumentet e udhëtimit, 6. Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore, 7. Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, 8. Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dhe 9. Ligjin për kufijtë administrativë komunalë. Shih me gjerësisht: Arkivi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Procesverbal nga seanca e Kuvendit, të mbajtur me 20 shkurt 2008, f. 1-3.

Kuvendi i Kosovës, duke kryer detyrën e tij sipas rekomandimeve të Planit të Ahtisaarit, hodhi kështu një hap të rëndësishëm drejt forcimit të institucioneve të Kosovës dhe ndërtimit të bazës ligjore për funksionimin e shtetit të pavarur.

Pavarësisë së Kosovës nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës,<sup>61</sup> ceremonitë zyrtare u përqendruan edhe te zbulimi i obeliskut NEWBORN, para Pallatit të Rinisë, ide e Fisnik Ismailit. Në këtë monument vendosën nënshkrimet e para Presidenti Fatmir Sejdiu, Kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe Kryeministri Hashim Thaçi. Festimet zyrtare u përmyllën me një koncert të Filharmonisë së Kosovës.

## **Njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës (2008-2015)**

Shtetet e para që e njohën Kosovën më 17 dhe 18 shkurt 2008 ishin: Republika e Kostarikës, më 17 shkurt 2008; Republika Islamike e Afganistanit, më 18 shkurt 2008; Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 18 shkurt 2008; Republika Franceze, më 18 shkurt 2008; Republika e Shqipërisë, më 18 shkurt 2008; Republika e Turqisë, më 18 shkurt 2008; dhe Mbretëria e Bashkuar, më 18 shkurt 2008. Shtetet e Bashkuar të Amerikës e njohën pavarësinë e Kosovës më 18 shkurt 2008. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George W. Bush, i cili gjendej në një vizitë në Tanzani, nga qyteti i Dar es Salaam, beri këtë deklaratë para mediave: *“Të dielën, populli i Kosovës shpalli pavarësinë e tij. Ata kërkuan njohjen diplomatike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe dje Shtetet e Bashkuara e njohën formalisht Kosovën si një komb sovran dhe të pavarur. Në shpalljen e saj të pavarësisë, Kosova angazhoi veten për standardet më të larta të demokracisë, duke përfshirë lirinë, tolerancën dhe drejtësinë për qytetarët e të gjitha grupeve etnike. Këto janë parime që nderojnë dinjitetin njerëzor, janë vlera që Amerika i kërkon nga një mik, dhe së shpejti ne do të vendosim marrëdhënie diplomatike të plota me kombin e ri të Kosovës.”*

Pas këtyre shteteve, ka vazhduar njohja zyrtare edhe nga këto shtete të tjera: Komonuelthi i Australisë, më 19 shkurt 2008; Republika e Senegalit, më 9 shkurt 2008; Republika Federale e Gjermanisë, më 20 shkurt 2008; Republika e Letonisë, më 20 shkurt 2008; Mbretëria e Danimarkës, më 21 shkurt 2008; Republika e Estonisë, më 21 shkurt 2008; Republika Italiane, më 21 shkurt 2008; Dukati i Madh i Luksemburgut, më 21 shkurt 2008; Republika e Perusë, më 22 shkurt 2008; Mbretëria e Belgjikës, më 24 shkurt 2008; Re-

<sup>61</sup> Joachim Rücker nga Gjermania, i cili drejtoi UNMIK-un nga 1 shtatori 2006 deri në korrik 2008, si dhe gjeneral-lejtnant Xavier de Marnhac, i cili drejtoi KFOR-in nga 31 gusht 2007 deri më 29 gusht 2008, ishin në krye të këtyre institucioneve në ditën kur Kosova shpalli pavarësinë.

publika e Polonisë, më 26 shkurt 2008; Konfederata Zvicerane, më 27 shkurt 2008; Republika e Austrisë, më 28 shkurt 2008; Republika e Irlandës, më 29 shkurt 2008; Mbretëria e Suedisë, më 4 mars 2008; Mbretëria e Holandës, më 4 mars 2008; Islanda, më 5 mars 2008; Republika e Sllovenisë, më 5 mars 2008; Republika e Finlandës, më 7 mars 2008; Japonia, më 18 mars 2008; Kanada, më 18 mars 2008; Principata e Monakos, më 19 mars 2008; Republika e Hungarisë, më 19 mars 2008; Republika e Kroacisë, më 19 mars 2008; Republika e Bullgarisë, më 20 mars 2008; Principata e Lihtenshtajnit, më 25 mars 2008; Republika e Koresë, më 28 mars 2008; Mbretëria e Norvegjisë, më 28 mars 2008; Ishujt Marshall, më 17 prill 2008; Burkina Faso, më 23 prill 2008; Republika e Naurut, më 23 prill 2008; Republika e Lituanisë, më 6 maj 2008; Republika e San Marinos, më 12 maj 2008; Republika Çeke, më 21 maj 2008; Republika e Liberisë, më 30 maj 2008; Republika e Sierra Leones, më 11 qershor 2008; Republika e Kolumbisë, më 4 gusht 2008; Belize, më 7 gusht 2008; Republika e Maltës, më 22 gusht 2008; Shteti i Pavarur i Samoas, më 15 shtator 2008; Republika Portugeze, më 7 tetor 2008; Mali i Zi, më 9 tetor 2008; Republika e Maqedonisë, më 9 tetor 2008; Emiratet e Bashkuara Arabe, më 14 tetor 2008; Malësia, më 30 tetor 2008; Shtetet Federale të Mikronezisë, më 5 dhjetor 2008; Republika e Panamasë, më 16 janar 2009; Republika e Maldiveve, më 19 shkurt 2009; Republika e Palaut, më 6 mars 2009; Republika e Gambisë, më 7 prill 2009; Mbretëria e Arabisë Saudite, më 20 prill 2009; Bashkimi i Komoreve, më 14 maj 2009; Mbretëria e Bahreinit, më 19 maj 2009; Mbretëria Haxhimit e Jordanisë, më 17 korrik 2009; Republika Domenikane, më 10 korrik 2009; Zelanda e Re, më 9 nëntor 2009; Republika e Malavit, më 14 dhjetor 2009; Mauritania, më 14 shtator 2010; Mbretëria e Swazilandit, më 12 prill 2010; Republika e Vanuatus, më 28 prill 2010, Republika e Xhibutit, më 8 maj 2010; Republika Federale e Somalisë, më 19 maj 2010; Republika e Hondurasit, më 3 shtator 2010; Republika e Kiribatit, më 29 tetor 2010; Tuvalu, më 18 nëntor 2010; Shteti i Katarit, më 7 janar 2011; Republika e Guineas-Bisau, më 10 janar 2011; Sultnati i Omanit, më 4 shkurt 2011; Principata e Andorrës, më 8 qershor 2011; Republika e Afrikës Qendrore, më 22 korrik 2011; Republika e Guineas, më 12 gusht 2011; Republika e Nigerit, më 15 gusht 2011; Republika e Beninit, më 18 gusht 2011; Shën Lucia, më 19 gusht 2011; Republika e Gabonit, më 15 shtator 2011; Republika e Bregut të Fildishtë, më 16 shtator 2011; Shteti i Kuvajtit, më 11 tetor 2011; Republika e Ganës, më 23 janar 2012; Republika e Haitit,

më 10 shkurt 2012; São Tomé dhe Príncipe, më 13 mars 2012; Brunei Darussalam, më 25 prill 2012; Republika e Chadit, më 1 qershor 2012; Republika Demokratike e Timorit-Leste, më 20 shtator 2012; Shteti i Pavarur i Papuasë së Guinesë së Re, më 3 tetor 2012; Republika e Burundit, më 16 tetor 2012; Republika e Fidzhit, më 19 nëntor 2012; Shën Kitsi dhe Nevis, më 28 tetor 2012; Komonuelthi i Dominikës, më 11 dhjetor 2012; Republika Islamike e Pakistanit, më 25 dhjetor 2012; Republika Kooperativiste e Guianës, më 16 mars 2013; Republika e Bashkuar e Tanzanisë, më 29 maj 2013; Republika e Jemenit, më 11 qershor 2013; Republika Arabe e Egjiptit, më 26 qershor 2013; Republika e El Salvadorit, më 29 qershor 2013; Mbretëria e Tajlandës, më 24 shtator 2013; Grenada, më 25 shtator 2013; Shteti i Libisë, më 25 shtator 2013; Mbretëria e Tongës, më 15 maj 2014; Mbretëria e Lesotës, më 11 shkurt 2014; Republika Togoleze, më 2 korrik 2014; Ishujt Solomon, më 5 gusht 2014; Ishujt Kuk, më 18 maj 2015; Antigua dhe Barbuda, më 19 maj 2015; Niue, më 23 qershor 2015; Republika e Surinamit, më 8 korrik 2016; Republika e Singaporit, më 1 dhjetor 2016; Republika Popullore e Bangladeshit, më 27 shkurt 2017; Madagaskari, më 24 nëntor 2017; Barbados, më 15 shkurt 2018; Izraeli, më 1 shkurt 2021; Kenya, më 26 mars 2025; Sudani, më 13 prill 2025; dhe Republika Arabe e Sirisë<sup>62</sup>, më 29 tetor 2025.

## Përfundime

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme historike të kombit shqiptar që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë me 1912. Ky akt përmbylli një periudhë të gjatë të përpjekjeve shekullore të popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje, e cila nisi me rezistencën e organizimit institucional, vijoi me luftën çlirimtare dhe arriti kulmin me angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare.

---

<sup>62</sup>Më 29 tetor 2025, Siria njoftoi zyrtarisht njohjen e Republikës së Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran, gjatë një takimi të organizuar në Riad, ku morën pjesë Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani, Presidenti sirian Ahmad alSharaa dhe Princi i Kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman, si ndërmjetësues. Në takim mori pjesë edhe Myftiu i Kosovës, Naim Tërrnava. Ky akt u bazua në parimin e të drejtës për vetëvendosje dhe shënoi hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet diplomatike midis Kosovës dhe Sirisë. Njohja përbën një moment historik për Kosovën dhe një sinjal të gatishmërisë për bashkëpunim politik, ekonomik dhe kulturor në rajon.

Deklarata e pavarësisë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, shpalli shtetin e ri sovran dhe demokratik, të bazuar mbi parimet e lirisë, barazisë, të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

Nëpërmjet mbështetjes ndërkombëtare dhe respektimit e zbatimit të Planit të Ahtisaarit, Kosova hodhi themelet e shtetësisë dhe filloi ndërtimin e institucioneve të saj të pavarura. Ky akt historik, ndonëse u kundërshtua nga Serbia dhe disa shtete të tjera, u njoh shpejt nga shumica e vendeve perëndimore dhe nga organizatave të rëndësishme ndërkombëtare. Pavarësia e Kosovës shihet si një realitet i pakthyeshëm, që i shërben paqes dhe stabilitetit rajonal, duke u shndërruar në një shembull të forcës së vullnetit të popujve për liri dhe demokraci. Rruga e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike vazhdon, me shpresën për një të ardhme edhe më të sigurt dhe më prosperuese. Legjitimitetin kryesor ndërkombëtar shpalljes së Pavarësisë së Kosovës ia dha pikërisht vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), i datës 22 korrik 2010, sipas të cilit, “Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008, nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.” Ky akt i rëndësishëm juridik i forcoi bazat e pavarësisë së Kosovës dhe hapi rrugën për njohje të mëtejshme nga shtetet e tjera.

